

## Udhëzime për marrjen me qera të ambienteve të banimit nga përfituesit sipas Kodit Social Gjerman II dhe Kodit Social Gjerman XII

**Para përfundimit të një kontrate të re qeraje** Ju keni nevojë për **garanci** nga Qendra e Punës team.arbeit.hamburg ose më saktë nga Zyra Profesionale për sigurinë bazë dhe çështjet sociale për shpenzimet e shpërnguljes ( p.sh. kosto shpërnguljeje, depozitë). Përveç kësaj për interesin Tuaj Ju duhet të merrni gjithashtu një **garanci** nga Qendra e Punës team.arbeit.hamburg apo më saktë nga Zyra Profesionale për sigurinë bazë dhe çështjet Sociale për të marrë përsipër kostot për banesën e re.

Garancia për mbështetjen financiare realizohet ose mbi bazë të një kontrate qeraje ( ende e panënshkruar) ose në bazë të një oferte qeraje.

Ju lutemi kontrolloni **para nënshkrimit të Kontratës Tuaj të Qerasë, nëse të dhënat në kontratën e qerasë përputhen me të dhënat në ofertën për qera**. Tregoni veçanërisht kujdes për **shumën e qerasë** dhe nëse ka një marrëveshje për një **rritje qeraje**. Nëse jeni të pasigurtë, mos e firmosni kontratën e qerasë, por paraqiteni atë ke eksperti Juaj.

Një detyrim për të rënë dakord për shpërnguljen Tuaj, ekziston për Qendrën e Shërbimit, vetëm nëse shpërngulja është e domosdoshme.

### Strehime të financuara me fonde publike

Nëse keni në plan të merrni me qera një banesë me subvencionim publik, në raste të caktuara Ju keni nevojë për një **Leje për strehim të subvencionuar, një certifikatë urgjence ose një konfirmim urgjence**.

Marrja me qera në këto raste është e lidhur me madhësinë e banesës.

**Madhësitë e apartamenteve të mëposhtme konsiderohen të përshtatshme:**

Madhësi për familje për persona	1	2	3	4	5	6	Çdo person tjetër
Vlera më e lartë e sipërfaqes së banimit	50m <sup>2</sup>	60 m <sup>2</sup>	75 m <sup>2</sup>	90 m <sup>2</sup>	105 m <sup>2</sup>	120 m <sup>2</sup>	15 m <sup>2</sup>

### Apartamente të vetëfinancuara

Nëse bëhet fjalë për banesë të vetëfinancuar apo për një banesë me subvencionim publik, atëherë do të vlejné vlerat më të larta për qera neto si në vijim:

Madhësi familje	Vlera më e lartë (Qera neto adekuate)
-----------------	--

Familje me 1 person	373,50 Euro
Familje me 2 persona	448,20 Euro
Familje me 3 persona	546,75 Euro
Familje me 4 persona	619,65 Euro
Familje me 5 persona	812,86 Euro
Familje me 6 persona	913,42 Euro
Çdo person tjetër	100,56 Euro

Vlerat më të larta formojnë në thelb vetëm kufirin më të lartë. Nuk ekziston asnjë e drejtë për të shfrytëzuar këto kufizime në çdo rast individual në tërësinë e tij. Nëse Ju ofrohet një banesë me kosto të leverdisshme, e përshtatshme për nevojat Tuaja, Ju duhet ta merrni atë me qira.

**Nëse jeni detyruar që për shkak të një qeraje neto tepër të lartë, të ulni shpenzimet, atëherë qeraja neto e ardhshme nuk duhet të tejkalojë vlerën më të lartë të vlefshme për madhësinë e familjes Tuaj.**

Ju lutem paraqisni me fatura reduktimet shtesë për shpenzimet operative dhe për ngrohje.

Nëse keni pyetje të tjera, Ju lutemi të kontaktoni me ekspertin Tuaj.